



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 594, datë 26.11.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË
NË GJYKATËN E LARTË, PËR KANDIDATEN ZNJ. ETLVA TEMO

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 26.11.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. Etleva Temo nga kandidimi në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë”, përparitur nga relatori z. Ilir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. Etleva Temo,

VËREN

I. TË DHËNA PËR PROCEDURAT DHE KËRKESAT E KANDIDATES

1. Me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

...

3. Afati i kandidimit është pesë muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

2. Vendimi i Këshillit si më lart për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Lartë, është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e kësaj procedure. Pas publikimit të vendimit, afati e kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020, duke përfunduar ky afat në datë 30.07.2020.

3. Me Vendimin nr. 243, datë 09.07.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”.

...

3. Afati i kandidimit është deri më datë 30.07.2020”.

4. Vendimi i Këshillit sipas pikës 3 për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Lartë, është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 09.07.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e kësaj procedure. Pas publikimit të vendimit, afati e kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 10.07.2020.

5. Brenda afateve të kandidimit për dy pozicionet e lira si më lart, pra atë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020 dhe atë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 243, datë 09.07.2020, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. Etleva Temo (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

6. Me Vendimin nr. 268, datë 07.08.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale), si dhe me Vendimin nr.245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës administrative), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 5. Për kandidaten znj. Etleva Temo - relator z. Ilir Toska; ...”.

7. Më datë 07.08.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidates, në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë, në kushtet kur ajo është subjekt rivlerësimi “*ex officio*” sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që për kandidaten nuk ka përfunduar, referuar nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë”, si dhe pikës 2¹, Seksioni B, Kreu X, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), me Shkresën nr. 3870 prot., datë 11.08.2020, i është kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimi me përparësi i procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatës.

10. Po të njëjtën datë, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatës iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

11. Brenda afatit pesëditor, kandidatja znj. Temo, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 268, datë 07.08.2020 për dorëzimin e një prej formularëve, që ishte data 11.09.2020, ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përsa kohë ky i fundit nuk e ka njoftuar Këshillin për mosdorëzimin e këtij formulari nga ana e kandidatës në afatin e përcaktuar.

12. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 13.08.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidaten znj. Temo.

13. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr.87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020 është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.87, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Ndërsa në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.243, datë 09.07.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të*

¹ *“Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk i përgjigjet kërkesës së Këshillit ose nuk përfundon procedurat e rivlerësimit për këta kandidatë brenda 3 muajve nga momenti i paraqitjes së kërkesës, këta kandidatë i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”*.

ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronja “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtyre dy vendimeve, përcaktohet se: “c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

14. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kritereve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. Etleva Temo u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

15. Në përfundim të verifikimit të tre kritereve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, me Vendimin nr. 323, datë 17.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. Etleva Temo, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020. ...”.

16. Ndërsa për kandidaten vijonte procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës dhe Këshilli ishte në pritje të përfundimit me përparësi të procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten, me Shkresën nr. 6822 prot., datë 16.10.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njoftoi Këshillin e Lartë Gjyqësor për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për kandidaten dhe se me Vendimin nr. 307, datë 12.10.2020, kishte vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Temo, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë”, çka përbën masë disiplinore në kuptim të neneve 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

17. Në vijim të procedurës së verifikimit, ndërsa vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ende nuk ishte arsyetuar dhe komunikuar znj.Temo, ndërkohë që kjo e fundit gëzon nga ligji të drejtën e ankimit kundër tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, situatë kjo sipas të cilës do

të sillte pezullimin *ex lege* nga detyra të saj sipas nenit 62 të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me Shkresën e datës 05.11.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3393/1 prot., datë 10.11.2020, kandidatja ka paraqitur një kërkesë për heqje dorë nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

18. Në rrethanat sa sipër, relatori përgatiti relacionin përkatës, bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”*.

19. Në Mbledhjen e datës 24.11.2020, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit paraprak të ndjekur për kandidaten znj. Etleva Temo, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. Etleva Temo, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

II. SHQYRTIMI I KËRKESËS SË KANDIDATES DHE VLERËSIMI I SAJ

20. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 136, pika 1 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se: *“1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi... 3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit”*, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin).

21. Këshilli në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrën në Gjykatën e Lartë edhe për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, duke u mbështetur në një sërë ligjesh, midis tyre dhe në Kodin e Procedurave Administrative, miratuar me Ligjin 44/2015. Ky Kod përcakton se procedura administrative për kandidatin përkatës inicohet me kërkesën për shprehje të interesit nga ana e kandidatit për t’u bërë pjesë e një procedure të caktuar, e cila finalizohet me një vendim në favor ose jo të kandidatit. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti mund edhe të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga ana e organit kompetent dhe për rrjedhojë, procedura e inicuar mund të përfundohet pa një vendim përfundimtar. Konkretisht, në nenin 64, pikat 2 dhe 4 të Ligjit 44/2015 përcaktohet se: *“...2. Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim,*

mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohej me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka...4. Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera”.

22. Kjo e drejtë ligjore, në rastin e procedurës administrative që realizon Këshilli, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ka gjetur rregullim specifik në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit 75/2019, që përcakton se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në fazën zyrtare të Këshillit”.*

23. Në vijim, detyrimi i organit publik, konkretisht Këshillit, për të disponuar në rast të tërheqjes nga kandidimi nga procedura përkatëse e kandidatit, gjen rregullim në pikën 17, seksioni B, Kreu VI të të njëjtit Vendim, ku përcaktohet se: *“Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin përfundimtar mbi përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.*

24. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja znj. Etleva Temo, brenda afatit të kandidimit, ka paraqitur kërkesë për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë, pikërisht të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim përfundimtar për këtë, kandidatja u tërhoq nga kandidimi në këto procedura ngritjeje në detyrë, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në letër, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i saj për t’u tërhequr nga kandidimet.

III. KONKLUZIONE

25. Në rrethanat si më lart, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja znj. Etleva Temo të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet e tij nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, në kushtet kur këto procedura për kandidaten janë inicuar me kërkesë të saj, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të deklaruar përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë për këtë candidate.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, në pikën 3, të nenit 93 dhe në pikën 1, të nenit 94, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. Etleva Temo, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. Etleva Temo, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR